



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 3046/ prot.
6

Pogradec, më 21.07, 2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Znj. Manjola KAMOLLI
KRYETARE E
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

E nderuar znj. Kryetare !

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

“Miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në agjencinë shtetërore të kadastrës për lidhjen e kontratave para noterit”

Me respekt:

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: ____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: ____

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: ____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____ . 2026

PROJEKT-VENDIM
NR. ____ , DATË ____ . ____ . 2026

“MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE, TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT”

Në mbështetje të nenit 41 dhe 113, pika 2 të Kushtetutës, Neneve 168, 169 të Kodit Civil, nenit 9, 54, 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", nenit 39/1, pika 1 e ligjit nr.9232, datë 13.05.2004 për "Programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane"; pikës 1 dhe 14 të VKM-së nr.97, datë 03.02.2008 për "Procedurat e privatizimit të banesave shtetërore":

Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave, përkatësisht lidhja e kontratave të shitblerjes para noterit, banesat e të cilëve kanë mangësi juridike pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Pogradec si shkak i mungesës së vulës apo nënshkrimit të noterit për:

NR	EMËR MBIEMËR	ADRESA
1	Risto Çomo	Pogradec Lagjia nr.2, Rr "Cene Mane"
2	Sofije Kullolli (Trashëgimtarët e Sterjo Kullolli)	Pogradec Lagjia nr.2, Rr "Rinia"
3	Myzejen Zylali (Trashëgimtarët e Kasëm Zylali)	Çërravë, Qershizë
4	Taibe Hoxha (Trashëgimtarët e Agim Hoxha)	Pogradec Lagjia nr.2 "Kisha e Re"
5	Gjergji Ibrahim	Pogradec Lagjia nr.

2. Shpenzimet Noteriale dhe tarifat për veprimet e regjistrimit në ASHK do të kryhen nga familjet përfituese.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar për lidhjen e kontratës së privatizimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARE
Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 3046 Prot
16

Pogradec, më 21.07.2026

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE, TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENSINË SHTETËRORE TË KADASTRËS PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT”

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Në Mbështetje të Nenit 13, pika 2 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar:
“Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.”

Po kështu, në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton:
“Akt me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore”.

Më tej, ky ligj në Nenin 8, shkronja “a” përcakton se : “është përgjegjësi e Prefektit të Qarkut, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.”

Nga sa më sipër, organet përgjegjëse pranë Bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.



Bazuar në Ligjin 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", neni 3, pika 2 përcakton si vijon:

"*Akt normativ nënligjor*" është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Ky projekt-vendim nuk ka karakter normativ, pasi nuk vendos rregulla të përgjithshme dhe abstrakte për një numër të pacaktuar subjektësh, por trajton marrëdhënie konkrete juridike ndërmjet bashkisë dhe subjekteve përkatëse.

Neni 3 pika 1 shkronja "a" e Kodit të Procedurave Administrative jep kete perkufizim për "Aktin administrativ":

a) "*Akti administrativ individual*" është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektësh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) "*Akti administrativ kolektiv*" është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektësh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Në rastin e këtij projekt-vendimi, gjykojmë se ai është një projekt-vendim, i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 1 "b", të Ligjit 44/2015 të "Kodi i Procedurës Administrative", pra përbën një akt administrativ kolektiv, i cili u drejtohet personave të caktuar të listuar me emër dhe adresë duke prodhuar pasoja juridike vetëm për ata.

Po kështu, ky projekt-vendim nuk synon të privatizojë sot banesat, por të konstatojë dhe konfirmojë përfundimin e procedurave të privatizimit të kryera më parë, të cilat kanë mbetur të pa u regjistruar për shkak të mangësive formale në dokumentacion. Vendos për një situatë konkrete, që është përfundimi i procedurave të privatizimit dhe autorizimin për lidhjen e kontratave.

Perfundimisht konkludojmë se: Projekt-vendimi paraqitet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe si i tillë nuk kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë.

Konceptoi: N.NAUN

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KRYETARI

Nr. 3076 prot.

Pogradec, më 31.07, 2026

RELACION

"MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE, TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT"

Të nderuar Këshilltarë!

Referuar korrespondencës institucionale midis Bashkisë Pogradec dhe ASHK me nr.1669/3.prot dt.14.05.2026 dhe nr.1669/4.prot dt.08.06.2026, si dhe nga kërkesa nga disa familje të cilat posedojnë kontrata privatizimi dhe dokumenta pronësie, **por që rezultojnë me mangësi formale në arkivën e ASHK-së (mungesë e nënshkrimit apo vulës së noterit), ju bëjmë me dije se nga:**

Analiza e Faktit: Edhe pse qytetarët kanë shlyer vlerën e banesës dhe kanë poseduar objektin në mirëbesim për mbi 30 vite, ky gabim administrativ i ish-Ndërmarrjes së Banesave, është bërë shkak për rifreskimin e kartelave të pasurisë në mënyrë që ata të tjetërsojnë ato juridikisht duke kryer veprime juridike si kontrata dhurimi, shitje, bankare, hipotekore etj... Sipas praktikave të konsoliduara, Bashkia si pasuese ligjore e këtyre aseteve ka detyrimin të kurojë këto mangësi përmes vullnetit politik të organit vendimmarrës (Këshillit Bashkiak Pogradec).

Synimi i Aktit: Ky projekt-vendim synon të përfundojë procedurën e privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK për lidhjen e kontratave para noterit sipas listës emërore të bashkëlidhur, duke **njohur** procesin e privatizimit si të kryer rregullisht në mënyrë që familjet më pas të aplikojnë rregullisht për ASHK për rifreskim të kartelave të pasurive.

Ky projekt-vendim vjen si një detyrim për të përmbushur një rekomandim apo një ngërc formal-administrativ midis qytetareve (pronare aplikues) dhe ASHK-së, i cili prek disa familje.

Për familjet e listuara në **Aneksin 1**, procesi i privatizimit ka përfunduar rregullisht në vitet 1994-2007. Mbi bazën e urdhrave të ish-drejtesve të ZVRPP-së, këto pasuri janë regjistruar rregullisht në regjistrat hipotekorë dhe qytetarët posedojnë Çertifikata Pronësie.

Gjatë auditimeve ndër vite, është konstatuar se në dosjet fizike të arkivës së ASHK-së, **kontratat e privatizimit të lidhura nga ish-Ndërmarrja Komunale e Banesave (NKB), mungon nënshkrimi ose vula e noterit të kohës** (sipas shkresës bashkëlidhur të ASHK-së).

Në vlerësimin ligjor, ky është një **gabim tërësisht formal i administratës shtetërore të asaj kohe** dhe jo i qytetarëve. Sipas ligjit, regjistrimi i kryer në ASHK nuk mund të anulohet apo të bëhet i pavlefshëm veçse me një vendim gjykate të formës së prerë. Qytetarët janë posedues të ligjshëm në mirëbesim për mbi 20-30 vite, gjë që sipas Neneve 168 dhe 169 të Kodit Civil (Parashkrimi Fitues), e bën pronësinë e tyre plotësisht të ligjshme.

Baza Juridike:



1. **Neni 41 i Kushtetutës së RSH** (E drejta e pronës private) dhe **Neni 1 i Protokollit 1 të kedni** (Mbrojtja e pronës): Shteti nuk mund të vërë në dyshim një pronë të regjistruar prej dekadash për një pasaktësi formale të vetë administratës.
 2. **Neni 114 i Kodit të Procedurave Administrative** (KPA - Parimi i Mirëbesimit/Legjitim): Qytetari nuk mban përgjegjësi dhe nuk mund të penalizohet për gabimet ose mangësitë e vetë organeve publike (ish-NKB apo noterët e kohës).
 3. **Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Nenet 168, 169** (Parashkrimi Fitues): Posedimi i qetë, pa ndërprerje dhe në mirëbesim për mbi 20 vite (madje në rastin tonë familjet janë pajisur edhe me titull pronësie të regjistruar), e bën pronësinë të padiskutueshme.
 4. **Ligji 7652, datë 23.12.1992** "Për privatizimin e banesave shtetërore" (i ndryshuar).
 5. **Ligji nr.9232/2004** për "Programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane"
 6. **Ligji 111/2018** "Për Kadastër"
 7. **Ligji 20/2020** "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".
 8. **Ligji 139/2015** "Për vetëqeverisjen vendore" (Neni 54, i jep të drejtë Këshillit të disponojë pronat, kompetenca ekskluzive e Këshillit Bashkiak për të konfirmuar vullnetin e institucionit për pasuritë që kanë qenë në fondin e tij).
 9. **Ligji 22/2018** "Për Strehimin Social"
 10. **Ligji nr.10112/2009 dhe Ligji 55/2015** "Për bashkëpronësinë".
 11. **VKM nr.97/2008** për "Procedurat e privatizimit të banesave shtetërore",
 12. **Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.2, datë 14.01.2015**. Ky udhëzim lejon Bashkinë që për të gjitha kontratat e mbetura përgjysmë ose me mangësi, të bëjnë **rikonfirmimin e listave** ose edhe **lidhjen e kontratave të reja shtesë/përmirësuese** mbi bazën e VKB.
- Për të mos zvarritur qytetarët nëpër gjykata për një "faj" të vetë shtetit, dhe në zbatim të parimit të **Sigurisë Juridike** dhe **Mirëbesimit** (Neni 114 i Kodit të Procedurave Administrative), propozojmë që Këshilli Bashkiak, si pasues ligjor, të **konfirmojë formalisht** vlefshmërinë e këtyre praktikave kjo pasi *Mungesa e nënshkrimit të noterit në dosjen e arkivës përbën një gabim tërësisht administrativ të organeve shtetërore të kohës (ish-NKB) dhe nuk mund të rëndojë mbi qytetarin, i cili ka vepruar në mirëbesim, ka shlyer detyrimet financiare ndaj shtetit dhe e posedon qetësisht banesën prej më shumë se 30 vitesh dhe për të cilat me "Urdhër të brendshëm të ish-drejtuësve të ish-ZVRPP ndër vite sot ASHK, pronat (apartamentet) janë regjistruar, është hapur regjistër dhe kartelë pasurie dhe është gjeneruar Çertifikatë pronësie, HTR dhe Kartelë. Ky akt juridik kërkohet sot për efekt të rifreskimit të kareleve të pasurive dhe në seksionin "D" dhe "E" të këtyre pasurive, duhet të jenë të pastra dhe pa shënime apo korigjime në mënyrë që më pas të zhblokohen juridikisht dhe pronarët të kenë të drejtë për të kryer veprime juridike të tjetërsimit të pronave si kontrata dhurimi, shitje etj...*

Relacionit i bashkëlidhet:

1. Shkresat e ASHK - Bashki nr.1669/3.prot dt.14.05.2026 dhe nr.1669/4.prot dt.08.06.2026.
2. Aneksi 1 (Tabela e Familjeve)
3. Certifikata Familjare e vitit 1992, Çertifikata familjare aktuale dhe personale

4. Kartela e Pasurisë dhe dokumenta/vertetime hipotekore (për të shmangur mbivendosjet).
5. Plan-vendosja dhe Planimetri e banesës.
6. Deklaratë / Deklarata Noteriale / Dëshmi Trashëgimie.
7. Vertetime që nuk ka detyrime për taksat.
8. Kontratë Energjie dhe Kontratë Uji (Librezat).
9. Procesverbal – Akt-konstatimi në terren në banesë nga Sektori i Strehimit



Sa më sipër, duke ju falenderuar për mbështetjen dhe bashkëpunimin, ftojme Këshilltarët e Këshillit bashkiak që ta votojnë këtë vendim!

Konceptoi: D.DRAGOJ

Pranoi: E.DULELLARI

Miratoi: N.TORRA

Konfirmoi: P.ZIKO

KRYETAR
Ilir XHAKOLLI

Aneksi 1 : Tabela



NR	EMËR MBIEMËR	ADRESA
1	Risto Çomo	Pogradec Lagjia nr.2, Rr "Cene Mane"
2	Sofije Kullolli (Trashëgimtarët e Sterjo Kullolli)	Pogradec Lagjia nr.2, Rr "Rinia"
3	Myzejen Zylali (Trashëgimtarët e Kasëm Zylali)	Çërravë, Qershizë
4	Taibe Hoxha (Trashëgimtarët e Agim Hoxha)	Pogradec Lagjia nr.2 "Kisha e Re"
5	Gjergji Ibrahim	Pogradec Lagjia nr.

R. 1669/2 P. 31
05.05.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE POGRADEÇ

Nr. 1669/2 Prot.

Pogradec, më 05.05.2026

LËNDA:

KTHIM PËRGJIGJE

DREJTUAR:

BASHKIA POGRADEÇ

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, PRONËSISË DHE
BASHKËPRONËSISË, ADMINISTRIMIT TË TOKËS DHE SUPERVIZIMIT TË
SHËRBIMEVE

SEKTORI I STREHIMIT, SHPRONËSIMEVE DHE BASHKËPRONËSISË

Adresa: Bulevardi "Reshit Çollaku", Lagjia nr 2, Pogradec.

Gjatë shoqytimit të kërkesës tuaj me nr 1669/1 prot ; dt 21.04.2026, administruar pranë DVASHK Pogradec me nr protokoll 1475 prot datë 22.04.2026, ku në mbështetje dhe zbatim të Ligjit të strehimit 22/2018, VKM-së nr 179 dt 26.02.2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qënë subjekt i ligjit nr 7652 dt 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore", VKM-së 898 dt 18.11.2020 "Rregullat, kushtet, kriteret e procedurave të privatizimit të banesave dhe objekteve të kthyer në fond banese të paprivatizuara", Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit 111/2018 "Për Kadastrën", Ligji 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", kërkonti nga DVASHK Pogradec bashkëpunimin institucional në vendosjen në dispozicion të dokumentacionit tekniko-ligjor i domosdoshëm për nevojat e trajtimit të procedurave që do të ndjeko Bashkia Pogradec në procesin e ndërmjetësimit me në bazë të kërkesave të qytetarëve të cilët kanë kontratat e shitblerejeve jo në formën e duhur ligjore për tu trajtuar nga DVASHK Pogradec në pajisjen me certifikatë pronësie.

Për sa më sipër cituar, si dhe nga verifikimi i kryer pranë DVASHK Pogradec, kjo e fundit ka evidentuar raste duke i përmbledhur në listë emërore si më poshtë vijon, bashkangjitur me referencën e dokumentacionit ligjor të administruar pranë arkivës së DVASHK Pogradec;

- o Pasuria nr 4/36+1-8, vol 1, fq 214, zk 8581, lloji apartament me sip 70m2, Indek Harte PG—D-4, Pogradec me pronar Donika Hoxha; Elda Karafili (Anxhela Filuçi, ref 214).
- o Pasuria nr 1/61+1-1, vol 2, fq 124, zk 8581, lloji apartament me sip 73m2, Indek Harte PG—D-4, Pogradec me pronar Xhelal Haxhi; Luan Haxhi; Zydi Haxhi (Luan Haxhi ref 8763).
- o Pasuria nr 6/39+1-14, vol 2, fq 204, zk 8582, lloji apartament me sip 70.46m2, Indek Harte PG—D-3, Pogradec me pronar Rozet Shkurti etj (Rozeta Shkurti ref 15242).
- o Pasuria nr 12/24+1-13, vol 4, fq 217, zk 8582, lloji apartament me sip 62m2, Indek Harte PG—D-3, Pogradec me pronar Kujtim Balliu etj (Kujtim Balliu, ka lidhur kontratë me Bashkinë Pogradec, ref 967)



Drejtoria Vendore e ASHK-së Pogradec, Adresa: Lagjia Nr. 2, katë 2-15 (Bashkia Pogradec)

- Pasuria nr 6/60+2-6, vol 6 fq 170, zk 8582, lloji apartament me sip 63 m2, Indek Hartë PG—D-3, Pogradec me pronar Risto Çomo etj, (ref 1381)
- Pasuria nr 5/64+1-19, vol 5 fq 243, zk 8582, lloji apartament, Indek Hartë PG—D-3, Pogradec me pronar Yqmet Xhambazi etj, (ref 1383)
- Pasuria nr 4/21+2-3, vol 1 fq 27, zk 8582, lloji apartament, me sip 54.56m2, Indek Hartë PG—D-4, Pogradec me pronar Suzo Çolaku etj, (ref 27)
- Pasuria nr 4/92+2-6, vol 1 fq 126, zk 8581, lloji apartament, me sip 70m2, Indek Hartë PG—D-4, Pogradec me pronar Gjergji Brshini (, ref 126)
- Pasuria nr 2/147+1-10, vol 3 fq 90, zk 8582, lloji apartament, me sip 81.53m2, Indek Hartë PG—C-3, Pogradec me pronar Guri Operaku (, ref 590)
- Pasuria nr 5/60+3-4, vol 4 fq 249, zk 8582, lloji apartament, me sip 100m2, Indek Hartë PG—D-3, B-3 Pogradec me pronar Neim Ballij (, ref 7371)
- Pasuria nr 6/60+2-6, vol 6 fq 170, zk 8582, lloji apartament, me sip 46,50m2, Indek Hartë PG—D-3, B-3 Pogradec me pronar Shaban Likollari (, Shaban Likollari, ref 1420)

- Përsa i përket shëtitasit z.Detahir Kavari dhe z.Muhamet Golemi sipas listës tual bashkëngjitur, nga verifikimet e kryera nuk rezultoi kartelë pasurie e hapur në regjistr kadastral, ku të këtë numër pasurie.
- Për shëtitasin z.Agron Kamolli ju bëjmë me dije se është certifikuar duke u pajisur me certifikatë pronësie sipas dokumentacionit të përcjellë me aplikim.

Për çdo rast të ngjashëm që DVASHK Pogradec do të këtë për tu trajtuar dhe për mungesë dokumentacioni tekniko-ligjor në lidhje me mungesën e nënshkrimit të kontratave të shitblerjes nga noteri, të cilat nuk janë trajtuar deri më tani, institucionit jonë do t'ju vëndosë në djeni mbi këtë problematike duke orientuar subjektet të paraqiten pranë Bashkisë Pogradec.

Marë parëshimë ju përcjellim kopje të dokumentit të kësaj lloji dhe ju informojmë se është bërë kështu.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

DREKTOR

FABIO LATRICKARI

Fabio

Drektor

Fabio Latrickari

Data: 20.05.2023

14/11/2023

14/11/2023

14/11/2023

14/11/2023

14/11/2023

14/11/2023

14/11/2023

14/11/2023

14/11/2023

14/11/2023

14/11/2023



Shëtitas Vendi i ASHK-së Pogradec, Adresa: Llogu Nr. 3, Janë 2-të (Bashkia Pogradec)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADec

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, PRONËSISË DHE BASHKËPRONËSISË
ADMINISTRIMIT TË TOKËS DHE SUPERVIZIMIT TË SMËRBIMEVE
SEKTORI I STREHIMIT, SHPRONËSIMEVE DHE BASHKËPRONËSISË

Nr. 166⁹⁹ / prot

Pogradec, më 21.04.2026

Lënda : Kërkesë

Drejtuar:

AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE (A.SHK) POGRADec

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit të strehimit 22/2018, VKM-179 dt.26.02.2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652 dt.23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", ligjit nr.9321 dt.25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndertuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore", VKM-898 dt.18.11.2020 "Rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave dhe objekteve të kthyera në fond banese të paprivatizuar", ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit 20/2020 "Për përfundimin e propesive kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, Ligjit 111/2018 "Për Kadastrën" ju bëjmë me dije si më poshtë vijon :

Pranë bashkisë Pogradec kanë mbërritur kërkesat e disa qytetarëve të cilët kanë kontrata blerje, privatizimi apo kalim pronësie por që kontratat janë pa Noter dhe për këtë ata kërkojnë ndërmjetësimin tonë për të ndjekur procedurën ligjore për tu pajisur me certifikata apo dokumenta pronësie të përditësuar nga ASHK.

Në kuadër të bashkëpunimit institucional, ju lutemi të na vini në dispozicion të gjithë dokumentacionin apo referencat për listën emërore bashkëngjitur kësaj kërkesë si dhe raste të tjera që ju keni (nëse keni) duke u shprehur se efarë mungese dokumentacioni kanë, në mënyrë që konform rregullit dhe ligjit, bashkia të vazhdojë procedurën e mëtejshme për në Këshillin bashkiak për miratim apo konfirmim.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin jemi të gatshëm t'ju japim çdo informacion që nevojitet.

(ME URDHER DHE DELEGIM)
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
DRIËN BABASHI

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, PRONËSISË DHE BASHKËPRONËSISË
ADMINISTRIMIT TË TOKËS DHE SUPERVIZIMIT TË SHËRBIMEVE
SEKTORI I STREHIMIT, SHIPRONËSIMEVE DHE BASHKËPRONËSISË

Nr. 1669/prot
3

Pogradec, më 14.05 2026

Lënda: Kërkesë për informacion

Drejtuar:

AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE (A.SH.K) POGRADEC

Në vazhdimësi të korrespondencës së përgjigjes tuaj mbërritur pranë Bashkisë me nr.1669/2.prot dt.05.05.2026, sikurse ju kemi theksuar në shkresën tonë drejtuar ASHK-Pogradec me nr.1669/1.prot dt.21.04.2026, ju lutemi të na bëni me dije duke specifikuar për çdo rast që u kemi dërguar ju sipas listës emërore apo dhe çdo rast që ju keni konkretisht se çfarë problematike juridike ligjore ka secila ; ka shënime në kartelë, janë PVP, ju mungon ndonjë faturë pagese, mungon kontrata e privatizimit, i kanë fotokopje, pa vule/firmë, i kanë të humbura si dokumenta, ka shënime apo detyra të lëna nga K.L.SH apo të tjera në mënyrë që më pas Bashkia ti trajtojë me relacion për VKB-Vendim të Këshillit Bashkiak për *për njohjen/konfirmimin administrativ të privatizimit të banesës*, pasi ;

Problematika apo mungesa e dokumentacionit për banesat që janë në qytet dhe që kanë kaluar procesin e privatizimit për pallatet/banesat para 1990 sipas ligjeve dhe akteve nenligjore të asaj kohe, të cilat i janë drejtuar zyrtarisht Bashkisë apo ASHK-së, juridikisht konsiderohen "Mangësi Dokumentacioni Arkivor", (jo domosdoshmërisht mungesë e së drejtës së pronësisë).

Në rastin kur familja ka hyrë/është strehuar ligjërisht në banesë para 1990, ka bërë privatizimin sipas ligjit të kohës, ka paguar faturat e privatizimit, ka marrë vendim privatizimi, disponon kontrate energjie ose kontrate uji-uk.shk dhe/apo është pajisur edhe me certifikatë pronësie, e drejta e pronësisë ekziston juridikisht por problemi/ngërçi është vetëm formalizimi ose plotësimi i dosjes arkivore të ASHK-së.

Sipas praktikës administrative dhe parimeve të Kodit të Procedurave Administrative, shteti nuk mund t'ia heqë qytetarit të drejtën e pronësisë vetëm sepse vetë administrata e asaj kohe ka humbur ose ka administruar keq dokumentet. Kontrata noteriale dhe dosja e privatizimit janë parashikuar në procedurat ligjore të privatizimit por do të duhet që ligjërisht të procedohet : *Hipoteka-ASHK-Kryhen verifikim administrativ në dosje, kërkesën apo arkivën e saj*. Agjencia Shtetërore e Kadastrës ASHK, nuk refuzon automatikisht qytetarin pasi fillimisht ASHK verifikon certifikatën ekzistuese të pronësisë, regjistrimin historik të pasurisë (origjina), kartelën e vjetër, indeksin

QYTETI I POGRADEC

NR. 2638 PROT

19.06.2026

Shënim
Shënim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Pogradec më 19.06.2026

KËRKESË

Në mbështetje të nenit 11, pika 4, nenit 13, 14, 15, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, nenit 28, ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, unë i/e nënshkruari/a **Z/ Znj. Sofije Kullolli** kërkoj nga Bashkia Pogradec sektori i Strehimit privatizimin e shtëpisë time pasi bashkëshorti im (Sterjo Kullolli) i cili ka ndërruar jetë dhe procesi për në hipotekë ka mbetur i pa përfunduar.

(Bashkëngjitur po ju dërgojmë dokumentat e nevojshme)

Emër dhe mbiemër:

Sofije Kullolli

Adresa:

Lagja nr.2, Rruga: "Reshit Çollaku", Pogradec

Nr. Tel. 0698251991

Ju faleminderit!

LETENDIPTETI ID REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA

Kulloshi
 mbiemri i familjes
Slerjo
 emri i parë
 Shqiptare/Albanian
 Librazhd, ALB
 16-09-1954
 04-04-2024
 HPB

035345969
 03-04-2034
 F408180320

SECRETARIA E REZERVES

LETENDIPTETI ID REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA

Kulloshi
 mbiemri i familjes
Slerjo
 emri i parë
 Shqiptare/Albanian
 Berat, ALB
 27-02-1954
 04-04-2024
 HPB

035245800
 03-04-2034
 F452270501



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
N.MIREMB.INFRASTRUKTURES

Nr 18 Prot

Pogradec me 18 /04/2014



VERTETIM

Vertetojme se Z.Servet KULLOLLI ka bere pagesen prane kesaj ndermarje per privatizimin e baneses se tij me MA Nr 240 dt 27/04/1993 si me poshte:


- ❖ Banesa 5840 lek
- ❖ Trualli 2807 lek
- ❖ Shpenzime 200 lek
- ❖ TOTALI 8847 lek

Leshohet ky vertetim me kerkesen e te interesuarit per efekt dokumenti.



PLANIMETRIA E PRONES

SHK.1:100



PERFAQJA FAKTIKE ESHTË
IPERFAQJA PREJ 66.42 M2

SHK.1:1500



DODHJA SIPAS HARTES SE Z.R.P.P

PUNOI
Ing.Vasil XHOGA

PLAN RILEVIMI

PERGATITI

Emri: Vasil XHOGA

Licensa Nr.T 0218/2 Data: 30 / 05 / 2005

Data e pergatitjes: 10 / 04 / 2014

Ing. Vasil XHOGA
T 0218/2 Vp0039
Vullasima

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 8581

NR I PASURISE 4/5+1- VOL FQ

INDEKSI I HARTES PG-D-4

SHKALLA 1:1500; 1:100

ADRESA E PASURISE: Rrethi POGRADEC

Q/F Pogradec Rr/Lagja Nr.2 Ruga "Rinia"

P/G 184 Sh 1 K 5 Ap

PRONARI Servet KULLOLLI



VENDODHJA SATELITORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREKTORIA E EMERGENCAVE, STREHIMIT, PRONËSISË DHE BASHKËPRONËSISË
ADMINISTRIMIT TË TOKËS DHE SUPRAVEZANT TË SHËRBIMEVE

Nr. _____ prot.

Pogradec, më 14. 02. 2026

AKT-VERIFIKIMI

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

I mbajtur sot më datë 14/02/2026 lidhur me verifikimin gjendjes aktuale të banesës të
z. SOFIJE KULLOLL Fshati/Qytet, C.NR.02 Bashkia Pogradec

PAS INSPEKTIMIT NE BANESËN E ZGJ. SOFIJE
KULLOLL U KONSTATUA SE:
BANESË ISHTË E LLOJIT APARTAMENT PALLATI
NE KLASË I V ME SIP = 68.42 M². HYRJE LINDUR
1+1. BASHKANGJITUR PËR OSVOR BALT KALOT.

Mbas verifikimit u la detyrë:

TE KRYHOT PËRFUNDIMIN I PRËGATITJES SË PRIVATIZIMIT
TE BANESËS DHE ZGJ. SOFIJE KULLOLL KONTRAT
LIGJIT PËR PRIVATIZIMIN AGH SËLËNDRIT PORËKTOR
BASHKANGJITUR PËR OSVOR BALT DOKUMENTAR
NEZAKËTËS DHE TË DËTËS.

Tel: 0698257991

Ky akt-konstatimi mbahet në dy kopje, një për Bashkinë Pogradec dhe një kopje për subjektin.

Për Bashkinë Pogradec

Për subjektin

Eralet Bella
Orton Drogzi
Hamit
Sheh
Halit

Sofije Kulloll
Kr.

968/2
14.05.2026

06.05.2026

Kerkese

Drejtuar : Bashkisë Pogradec

Sektorit të privatizimit të banesave

Kerkuese : Myzejen Zylali e bija e Jashar dhe e Nedime, e datelindjes 21.01.1965, lindur në Pogradec dhe banuese në Edi Hymettari, nd.17, h.3, Cerrave, Qershize 7306, Pogradec, identifikuar me ID nr. 0391108140 dhe nr personal IG 55121019B, e vë nr.cel 06981102527, *perfaqesuar* nga av.Elta Kuvarati anetare e Dhomes së Avokatise Korce, me nr.license 9010, NUIS L74618003U, në mbështetje të vendimit nr 125 prot date 18.06.2025 me vendimin nr 41-2025-2067 data e vendimin 11.06.2025 me adrese :rr.Papallambro Ballamaci, lagjia 1, nr2, Korce, email:kuvaratie@gmail.com.tel 0692684003.

OBJEKTI : Dhenie informacioni për vazhdim të privatizimit në mbështetje të ligjit 22/2018"Per strehimin social" vkm 179, 26.02.2020 .

Te nderuar Myzejen Zylali është perfituese e ndihmes juridike falas dhe është në një proces gjyqësor për pasurinë e paluajtshme me nr.pas .330/9+1-3, vol.1, fq.88, zk.3108, Pogradec, të llojit apartament, me sipërfaqe 74,19 m2 e ndodhur në Pogradec, Qershize, e cila nuk ka kryer kontrastin e privatizimit tek noteri pra k atë gjithë dokumentacionin e plotësuar përveç kontratës bashkëngjitur shkresës.

Meqenëse gjatë gjykimit u pretendua nga pala avokatia e shtetit se kjo procedure mund të zgjidhet me rrugë administrative kërkojme nga ana juaj të verifikoni rastin dhe të na informoni në lidhje me procedurën që duhet ndjekur për perfundimin e regjistrimit të pronës.

